

Hapet thirrja e dytë për propozime projektsh në kuadër të Programit Interreg VI-B IPA Adriatic-Ionian 2021-2027 (IPA ADRION).

Synimi i Thirrjes:

Synimi i thirrjes është të mbështesë bashkëpunimin ndërkombëtar në Rajonin Adriatik-Jonian për të adresuar sfida të përbashkëta si ruajtja e biodiversitetit, ndryshimet klimatike dhe transporti i qëndrueshëm. Ajo synon zbatimin e modeleve dhe mjeteve inovative për të ndërtuar një rajon më të zgjuar, më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm.

Fushat e veprimtimit të thirrjes:

Thirrja fokusohet në këto prioritetet dhe objektiva specifike:

Prioriteti 1: Një rajon më i zgjuar

OS 1.1: Forcimi i kapaciteteve për inovacion.

Prioriteti 2: Një rajon më i gjelbër dhe i fortë ndaj klimës

OS 2.1: Përforsimi ndaj ndryshimeve klimatike dhe katastrofave.

OS 2.3: Mbështetja e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit.

Prioriteti 3: Një rajon neutral ndaj karbonit dhe më i lidhur

OS 3.1: Forcimi i mobilitetit të zgjuar dhe neutral ndaj karbonit.

Rezultatet e pritshme:

- Zhvillimi i strategjive të përbashkëta ndërkombëtare.
- Zbatimi i projekteve pilot për inovacion, reziliencë klimatike, turizëm të qëndrueshëm dhe mobilitet të zgjuar.
- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve dhe aktorëve lokalë/rajonalë.
- Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe reduktimi i ndarjes digjitale.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Në këtë thirrje mund të aplikojnë:

- Autoritetet publike në nivel kombëtar, qarku dhe vendor, dhe shoqatat e formuara nga një ose disa prej këtyre organeve publike;
- Organet e rregulluara nga e drejta publike dhe shoqatat e përbëra nga një ose disa organe të rregulluara nga e drejta publike, siç përcaktohet në nenin 2(4) të Direktivës 2014/24/BE për prokurimin publik;
- EGTC, në përputhje me nenin 23.6 i Rregullores Interreg. EGTC e pranueshme duhet të udhëhiqet nga ligji i një prej vendeve pjesëmarrëse të IPA ADRION ku EGTC ka selinë e saj të regjistruar. Një EGTC nuk mund të jetë partneri i vetëm i një projekt-propozimi IPA ADRION;
- Organet private, duke përfshirë kompanitë private, që kanë personalitet juridik;
- Organizatat ndërkombëtare sipas ligjit kombëtar të njërit prej vendeve pjesëmarrëse në IPA ADRION.

Konsorciumi i detyrueshëm:

- Minimumi **4 partnerë** të financueshëm nga **4 vende** të ndryshme pjesëmarrëse, përfshirë:

- Të paktën **2 partnerë** nga vendet ERDF (BE: Itali, Greqi, Slloveni, Kroaci)
- Të paktën **2 partnerë** nga vendet IPA (jo-BE: Shqipëri, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina, Serbia)

Aktivitetet e Pranueshme:

Aktivitetet e pranueshme mund të jenë vetëm ato të listuara si “indicative eligible actions” për çdo objektiv specifik, ndër to:

- Strategji të Smart Specialisation dhe rrjete inovative
- Plane për përshtatje klimatike dhe mbrojtje nga fatkeqësitë
- Plane për transport intermodal (hekurudhë-det)
- Veprime për mbrojtjen e biodiversitetit, ajrit, ujërave dhe tokës
- Rritja e qasjes në shërbime digjitale dhe inovacion social

Cili është buxheti i thirrjes:

Totali i fondeve të Interreg për thirrjen është **21.869.364,85 euro**, të ndara si më poshtë:

- Prioriteti 1, OS 1.1: 4.804.638,05 EUR
- Prioriteti 2, OS 2.1: 7.220.267,58 EUR
- Prioriteti 2, OS 2.3: 6.180.167,82 EUR
- Prioriteti 3, OS 3.1: 3.664.291,40 EUR

Çdo projekt mund të kërkojë një kontribut të BE-së **deri në 1.200.000 euro**, me financim **85%** nga IPA ADRION dhe bashkëfinancim **15%** nga burime kombëtare/vetjake.

Si bëhet aplikimi:

- Vetëm online, përmes sistemit JEMS: <https://jems.regione.emilia-romagna.it>
- Propozimi dorëzohet vetëm në anglisht, me të gjitha dokumentet mbështetëse.
- Aplikimi është në një fazë të vetme (jo në dy faza).

Kur është afati i fundit:

Afati për dorëzim: **30 Qershor 2025, ora 13:00 (CEST, ora e Romës)**

Linku i Thirrjes:

<https://www.interreg-ipa-adrion.eu/calls/2nd-call>